

UDHËZIM
Nr. 4, datë 4.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË KOMPONIMEVE TË PËRGJITHSHME
POLARE NË VAJRAT PËR SKUQJE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Vlera maksimale e komponimeve të përgjithshme polare (KPP) në vajrat e përdorura për skuqje nga operatorët e biznesit ushqimor, të jetë jo më shumë se 25 %.
2. Inspektorët e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, si dhe specialistët e laboratorëve të kontrollit të ushqimeve në varësi të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, të trajnohen për procedurat e kontrollit dhe të përcaktimit të KPP në vajrat e përdorura për skuqje.
3. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.
4. Zbatimi i këtij udhëzimi fillon 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi të tij.
Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË,
USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli